



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUČITRN	
02 Nr. / Br	54224/25
Nr. i fq. / Br. sf	- 1 -
Data: / Datum	13.10.25
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

02Nr. PB 963 /25

Dt, 13.10.2025

Bazuar në nenin 13, 17 shkronja "h" dhe 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 8, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1 të Ligjit nr. 08/L-153 për Edukimin në Fëmijërinë e Hershme, nenit 3, paragrafi 1 dhe nenit 7 të Udhëzimit Administrativ (MASHTI) nr. 10/2023 për Kriteret dhe Procedurat e Themelimit dhe Pushimit të Veprimtarisë së Institucioneve të Arsimit Parauniversitar, nenit 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës dhe pas marrjes së pëlqimit nga Ministria e Arsimit Shkencës Teknologjisë dhe Inovacionit nr. 2/2908 të datës: 28.07.2025 për themelimin e Institucionit për edukimin në fëmijërinë e hershme, Kryetari i komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Institucioni Parashkollor "FOLEJA 3" në Vushtri për edukimin në fëmijërinë e hershme.
2. IP "FOLEJA 3", është institucion parashkollor për edukim në fëmijërinë e hershme, i themeluar sipas legjislacionit në fuqi.
3. Obligohet Drejtoria për Arsim të siguroj kushtet e nevojshme që IP "FOLEJA 3" në Vushtri të ushtroj veprimtarinë si institucion edukativ arsimor sipas legjislacionit në fuqi në Republikën e Kosovës.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- QSHQ
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRN	
02 Nr. / Br	54552/25
Nr. i fq. / Br. sf	- 1 -
Data: / Datum	14.10.25
VUSHTRRI - VUCITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

02Nr. PB. 967 /25
Më, 14.10.2025

Bazuar në nenin 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/04 qershor 2008) nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, si dhe kërkesën Nr. prot. 10-104/02-0052468/25 datë 03.10.2025 të znj. Vjona Zekolli nga Maxhunaj, Vushtrri, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIM/MBËSHTETJE TË PROJEKTIT SHËNDETËSOR PROFESIONAL

1. Me këtë vendim miratohet kërkesa e znj. Vjona Zekolli nga fsh. Maxhunaj, Komuna Vushtrri, për mbështetje të projektit shëndetësor profesional "Analiza e ndikimit të ushqimeve të buta dhe të forta në zhvillimin e nifullës gjatë adoleshencës në shkollat e mesme të ulëta në komunën e Vushtrrisë", që do të realizohet në muajin nëntor 2025.
2. Bartës të këtij projekti do të jenë: ass. dr. Nora Aliu dhe dr. Vjona Zekolli – koordinatorë të projektit.
3. Komuna e Vushtrrisë do të ofroj mbështetje institucionale/financiare për implementim të projektit. Projekti do të realizohet në bashkëpunim me Drejtorinë për Arsim dhe Drejtorinë për Shëndetësi e Përkujdesje Sociale.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.


Ferit Idrizi
Kryetar i Komunës

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorisë për Arsim
- QSHQ
- Palës
- Arkivit



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPSTINA VUCITRN

02 Nr. / Br 54714/25

Nr. i fq. / Br. st - 1 -

Data: / Datum 15.10.25

VUSHTRRI - VUCITRN



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

Kryetari

02Nr. PB 972/25
Datë, 15.10.2025

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenin 4 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 të Rregullores (KKV) Nr. 03/23 prot. nr. 49/23 datë 23.02.2023 për Përcaktimin e Kriterëve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridik – OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, si dhe kërkesën propozimit të Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport datë 10.09.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Shoqatës “Hendikos” dega në Vushtri, i ndahen mjete financiare në shumë prej 250.00 € (dyqind e pesëdhjetë euro) për mbulim të shpenzimeve për zhvillim të aktiviteteve me rastin e shënimit të “Ditës ndërkombëtare për mundësi të barabarta” që do të mbahet në Vushtri me datën 16 tetor 2025.
2. Pagesa e mjeteve në shumën e cekur në pikën paraprake të këtij vendimi të bëhet nga buxheti i Drejtorisë për Administratë, sektori për të drejtat e njeriut. në llogari të . Në mungesë të mjeteve në këtë sektor, pagesa të kryhet nga njësia buxhetore në të cilën ka mjete të lira.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoresha e Drejtorisë për Administratë dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Administratë
- QSHQ
- Arkivit





REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISE-OPŠTINA VUÇITRAN	
02 Nr. / Br	55362 / 25
Nr. i fq. / Br. st	-1-
Data: / Datum	20.10.2025
VUSHTRRI - VUÇITRAN	



REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI
Kryetari

02Nr. PB 884 /25
Datë, 20.10.2025

Bazuar në nenin 13 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, nenin 44 paragrafi 1 të Statutit të Komunës, nenin 4 paragrafi 3 nënparagrafi 3.2 të Rregullores (KKV) Nr. 03/23 prot. nr. 49/23 datë 23.02.2023 për Përcaktimin e Kritereve të Ndarjes së Mjeteve Financiare nga Fondi për Transfere dhe Subvencione Personave Juridik – OJQ-ve dhe Ndihmë Momentale Personave Fizikë dhe Bashkëfinancim, dhe propozimit të Drejtorit të Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport datë 10.10.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Klubit të Futbollit të Veteranëve të Vushtrrisë iu ndahen mjete financiare në shumë prej 500.00 € (pesëqind euro) për zhvillim të aktiviteteve sportive – pjesëmarrje në gara.
2. Pagesa e mjeteve nga pika paraprake e këtij vendimi të bëhet, nga buxheti i Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport – Transfere dhe subvencione, në llogarinë bankare të këtij klubi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Kulturë Rini dhe Sport dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Ferit Idrizi

Kryetar i Komunës

Vendimi i dërgohet:

- Drejtorisë për Kulturë Rini dhe Sport
- QSHQ
- Arkivit